



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 14, Datë 07.03.2014

PËR

**MIRATIMIN E NISMËS PËR HARTIMIN E PLANIT TË INTEGRUAR  
NDËRSEKTORIAL PËR BREZIN BREGDETAR**

Në mbështetje të neneve 8, 29, 33, pika 3, 35, pika 1, neneve 36-39 dhe nenit 64 të Ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, Kreut V “Planifikimi i integruar” të VKM-së nr. 481, datë 22.06.2011 “Për Miratimin e Rregullores Uniforme të Instrumenteve të Planifikimit të Territorit”, VKM-së nr. 887, datë 03.10.2013 “Për Përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, si dhe në vijim të Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 1, datë 08.10.2013 “Për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese mjedisore në disa zona me rëndësi kombëtare dhe procedurën e hartimit të planit të integruar sektorial për brezin bregdetar”, me propozimin e Ministrit për Zhvillimin Urban dhe Turizmin, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e nismës për hartimin e Planit të Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar.
2. Fillimin e procedurës për ngritjen e grupit të punës me ekspertë me qëllim hartimin e Planit të Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar.
3. Pezullimin e dhënies së lejeve të reja zhvillimore, nga të gjitha autoritetet e planifikimit, në zonat e Brezit Bregdetar (sipas hartës që i bashkëlidhet nismës) deri në miratimin e Planit të Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar dhe në çdo rast jo përtej afatit maksimal të përcaktuar në ligj.



4. Deri në miratimin e Planit të Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar, autoritetet e planifikimit lejohen të japin leje zhvillimore vetëm për këto raste përjashtimore:
  - a) Punime mirëmbajtje;
  - b) Leje zhvillimore për interes publik, shtetëror dhe kombëtar.
5. Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të drejtojnë punën për hartimin e Planit të Integruar Ndërsektorial dhe të kryejnë bashkërendimin, këshillimin dhe organizimin e dëgjësave publike me të gjitha autoritetet e planifikimit dhe palët e interesuara.
6. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
  - a) Studimi që përcakton faktet dhe problemet, të cilat shprehin nevojën për hartimin e Planit të Integruar Ndërsektorial të Brezit Bregdetar,
  - b) Plani i veprimeve për hartimin e Planit të Integruar Ndërsektorial të Brezit Bregdetar,
  - c) Buxheti për hartimin e Planit të Integruar Ndërsektorial të Brezit Bregdetar,
  - ç) Kufijtë dhe përcaktimi në hartë i zonës që do të studiohet.
7. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**



**ZËVENDËS KRYETARE E KKT**

**Znj. EGLANTINA GJERMENI**

  


**MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT**

**SEKRETARE E KKT**

**Znj. ADELINA GRECA**

  


**DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT**